- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj të regjistruar me anë të një rezolute të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.

Neni 4

Objekti i Veprimtarisë

- 4.1 Fusha e veprimtarisë së shoqërisë në Shqipëri dhe jashtë saj është ndërtimi, operimi, menaxhimi i resorteve të turizmit, hoteleve; blerja, administrimi, qiradhënia dhe shitja e pronave të paluajtshme; sigurimi i shërbimeve të turizmit dhe / ose argëtimit (të tilla si, pa kufizime, klube golfi, klube jahtesh, etj.); blerja, shitja dhe menaxhimi i interesave dhe / ose pjesëmarrjeve në kompani të tjera (ekzistuese dhe / ose të mëvonshme) që ndjekin dhe ushtrojnë veprimtari ligjore në këtë fushë.
- 4.2 Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, operacione me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për t'u kryer dhe të përmbushë qëllimin e veprimtarisë së saj, duke specifikuar që aktiviteti financiar do të kryhet posacërisht në përputhje me keto fusha të aktivitetit.
- 4.3 Në përgjithësi, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm dhe të dobishëm, të lejuar nga legjislacioni në fuqi me qëllimin e përmbushjes dhe ushtrimit të fushës së veprimtarisë së saj.
- 4.4 Shoqëria mund të ofrojë shërbime të tjera dhe të kryejë veprimtari të tjera me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 4.5 Shoqëria mund të ndryshojë fushën e veprimtarisë së saj, në çdo kohë, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive Tregtare dhe këtyre akteve nënligjore.

Perkthyes zyrtar: Alketa SKENDAJ

Neni 5

Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj për një periudhë të pakufizuar kohore duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar.

5.2 Shoqëria mund të ndryshojë kohëzgjatjen e aktivitetit të saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në përputhje me rregullat e përcaktuara në të.

Neni 6

Degët dhe Zyrat Përfaqësuese

Shoqëria mund të hapë degë, filiale, zyra përfaqësuese dhe të kryejë aktivitete biznesi në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 7

Përgjegjësitë e ortakëve

- 7.1 Ortakët nuk janë përgjegjës për detyrimet e Shoqërisë dhe personalisht mbulojnë humbjet e Shoqërisë deri në kontributet e tyre të papaguara në kapitalin e shoqërisë.
- 7.2 Ortakët do të ushtrojnë detyrat e tyre me kujdesin e duhur dhe ndershmëri në përputhje me dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

KAPITULLI II

KAPITALI I SHOQERISE DHE KUOATAT, RRIJJA DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT TE PERBASHKET, TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 8

Kapitali dhe kuoatat e regjistruara

- 8.1 Kapitali i shoqërisë është në para, i barabartë me 10,000 EUR (dhjetë mijë Euro). Kapitali i shoqërisë është i papaguar.
- 8.2 Kapitali i shoqërisë është në pronësi dhe tërësisht i nënshkruar nga Ortakët si më poshtë:

- (i) **Finsec Ltd**, një kompani ekzistuese dhe e organizuar ligjet e Zvicrës, me seli të regjistruar në adresën: "Bahnhofstrasse 3, 8808 Pfäffikon SZ, Zvicër", dhe regjistruar me ID/Nr identifikimi CHE-114.323.183J, **pronar i 1 (një) kuote, në vlerën e 7,000 EURO (shtatë mijë Euro), që korrespondon me 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;**

Perkthyes zyrtar: Alketa SKENDAJ

- (ii) **Greg Xhillari**, shtetas shqiptar, i lindur me 16.01.1997, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr personal: J70116061L, **pronar i 1 (një) kuote, në vlerën 3,000 EUR (tre mijë Euro) , që korrespondon me 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.**

Neni 9

Rritja e kapitalit te shoqërisë

- 9.1 Kapitali i shoqërisë mund të rritet në çdo kohë, me një rezolutë/vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.
- 9.2 Në rast të rritjes së kapitalit, Ortakët ekzistues kanë të drejta paraprake për kuotimin e kuotave të reja në proporcion me vlerën nominale të kuotave ekzistuese tashmë të zotëruara në kapitalin e shoqërisë.

Neni 10

Zvogelimi i kapitalit të regjistruar

- 10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar, me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.
- 10.2 Ulja e kapitalit te shoqërisë ndikon tek Ortakët në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapital, përveçse kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Transferimi i kuotave të kapitalit të regjistruar

- 11.1 Dispozitat e nenit 11 të Statutit synojnë të mbrojnë interesat e Shoqërisë, unitetin e Ortakëve dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënies së tyre dhe për këtë qëllim zbatohen kufizimet e mëposhtme për transferimin e kuotave.
- 11.2 Transferimi i kuotave do të ekzekutohet vetëm përmes një dokumenti të shkruar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 11.3 Në rast se një ortak dëshiron të transferojë kuotën e tij (përfshirë një transferim pa kompensim) te palët e treta, transferimi i nënshtrohet të drejtës preferenciale të ortakeve ekzistues të kompanisë mbi kuotën (pjesë e kuotes) që synohet të transferohet, në përputhje me siç parashikohet në pikën 11.4 në paragrafin më poshtë

Për të shmangur çdo dyshim, transferimi i kuotave tek një palë e tretë çfarëdo në shkelje të të drejtave preferenciale të Ortakëve të tjerë është i parregullt dhe, për këtë arsye, është i pavlefshëm.

Perkthyes zyrtar: **Alketa SKENDAJ**

- 11.4 Ortaku që synon të shesë ose transferojë pjesën e tij në kapitalin e shoqërisë ose ndonjë pjesë të tij, duhet të njoftojë përmes një letre zyrtare ose përmes postës elektronike ("**Njoftimi i Transferimit**") Ortakun tjetër. Njoftimi duhet të përfshijë të dhënat personale të transferuesit dhe identifikimin e përfituesit, vlerën e kuotes (ose një pjesë të saj) që synohet të transferohet, konditat dhe kushtet e transferimit, përfshirë çmimin ("**Çmimi i Parashkuar**") dhe mënyra e pagesës.
- 11.5 Njoftimi i Transferimit do të specifikojë një periudhë ("**Periudha e Parashkuar**"), e cila nuk do të jetë më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data pasardhëse e lëshimit të Njoftimit për Transferim, periudhë brenda së cilës oferta duhet të pranohet ose refuzohet. Njoftimi për Transferimin i lëshuar një herë duhet të jetë i përvokueshëm.
- 11.6 Çmimi i përshkuar do të jetë një çmim që do të përcaktohet nga transferuesi dhe do të konsiderohet se pasqyron një vlerë të drejtë të shumës së kuotes.
- 11.7 Ortaku i njoftuar duhet të ushtrojë të drejtën e tij preferenciale mbi pjesëmarrjen e ortakut/transferuesit të treguar në njoftim, duke i dërguar ortakut që ofron dhe administratorit deklaratën për ushtrimin e së drejtës së tyre preferenciale me një letër zyrtare brenda afatit të parashkuar në njoftim.
- 11.8 Nëse deri në fund të Periudhës së Parashkuar, nuk është marrë asnjë njoftim pranimit ose jo e gjithë pjesa (ose një pjesë e saj) në Njoftimin e Transferimit nuk është pranuar nga blerësi, transferuesi do të ketë të drejtë të transferojë pjesën e tij të një palë e tretë në një çmim i cili nuk është më i ulët se Çmimi i Parashkuar. Transferuesi do të njoftojë paraprakisht me shkrim identitetin e palës së tretë ("**Transferuesi i Synuar**") të cilit ai synon t'ia shesë kuotat (ose një pjesë të saj) Ortakeve të tjerë të shoqërisë.
- 11.9 Pëlqimi me shkrim i Ortakut (eve) të tjerë për transferimin e kuotave tek Transferuesi i Synuar, do të konsiderohet një kusht paraprak për të drejtën e Ortakut për të transferuar pjesën e tyre (ose një pjesë të saj) të Transferuesit i Synuar.
- 11.10 Asnjë ortak nuk lejohet të hipotekojë, të vendosë si garanci, të lërë peng apo si barrë garancie kuotat e shoqërisë. Asnjë ortak nuk do të favorizojë në asnjë mënyrë për të përfituar ndonjë interes në lidhje me kuotat e mbajtura prej tyre (përveç transferimit në përputhje me dispozitat e këtij neni). Asnjë ortak nuk do të hyjë në ndonjë marrëveshje në lidhje me të drejtat e votës që lind nga posedimi i kuotave të tyre ose letrave me vlerë të tjera në Kompani ose të kryejë ndonjë favor në lidhje me to.
- Dispozitat e kësaj pike 11.10 mund të shfuqizohen vetëm në bazë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.
- 11.11 Çdo transferim i kryer në kundërshtim me dispozitat e mësipërme të këtij neni 11 do të konsiderohet i pavlefshëm dhe Ortaku transferues do të jetë përgjegjës ndaj Ortakut tjetër dhe Shoqërisë për dëmet e shkaktuara.
- 11.12 Dispozitat e këtij neni 11 zbatohen gjithashtu për pasardhësit ligjorë dhe / ose testamentarë të Ortakëve (sipas rastit).

Perkthyes zyrtar: Alketa SKENDAJ

KAPITULLI III

ORGANET ADMINISTRATIVE TE SHOQERISE

Neni 12

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve

Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e këtyre akteve nënligjore, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve, është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, kur merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet statutore aktuale, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për zgjidhjen e çështjeve të mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave financiare të Shoqërisë;
- b. ndryshimin e Statutit;
- c. emërimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- d. emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe auditorëve të autorizuar;
- e. ndarja e kuotave dhe anulimi i tyre;
- f. rritja ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
- g. aprovimi dhe miratimi i deklaratës vjetore të llogarive, të raporteve të administrimit dhe mbikëqyrjes;
- h. miratimin e rregullave procedurale në lidhje me mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve;
- i. miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore;
- j. miratimin e skemës së kompensimit për Administratorin, likuiduesit dhe auditorët e autorizuar;
- k. ristrukturimi, shpërbërja, transformimi, bashkimi, përfundimi ose likuidimi i shoqërisë ose riorganizimi i shoqërisë në një formë tjetër korporate;
- l. ndryshimi i statusit ligjor dhe / ose formës ligjore dhe mbylljen e shoqërisë;
- m. blerja e kuotave në kompani të tjera ose transferimi i kuotave të Shoqërisë ose të ndonjë pjesëmarrje që Shoqëria ka në shoqëri të tjera;
- n. themelimi, mbyllja dhe / ose mbarimi i çdo zyre dege, përfaqësie dhe filiali;
- o. të marre pjesë në cdo marrëveshje që siguron për pagesa gjate gjithë afatit të marrëveshjes perkatese që tejkalojnë vlerën prej 10,000,000 Euro (10 milione);
- p. cdo lloj shitje, blerje apo transferim të pronave/aseteve të paluajtshme të shoqërisë tek palet e treta;
- q. të shkaktoje ndonjë borxh ose të garantoje ndonjë borxh që tejkalon vlerën prej 10,000,000 Euro (10 milione Euro) për cdo borxh;
- r. të vendose për të mos shpërndare dividente sipas nenit 12 të këtij statuti (*Shpërndarja e fitimit*);

Perkthyes zyrtar: Alketa SKENDAJ

- s. angazhimin e shoqerise ne cdo biznes tjetër përcaktuar nga biznesit qe mbulon shoqeria;
- t. përcaktuar sa parashikohet dhe identifikohet ne menyre specifike nga buxheti (nese ka nje te tille), te behen shpenzime kapitale qe tejkalojne vleren prej 10,000,000 Euro (10 milione Euro) ne cdo vit fiskal. Kjo gje nuk duhet te paragjykoje pikat/germat "o" dhe "q" te ketij neni 13;
- u. fillimin ose zgjidhjen e cdo procesi gjyqesor material jashte rrjedhes se zakonshme te biznesit;
- v. cdo çështje tjetër e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe / ose këto akte statutore.

Neni 14

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve do të thirret në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe këto rregulla statutore, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve thirret në përputhje me nenet 83 dhe 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe këto rregulla statutore.
- 14.2 Administratori sipas gjykimit të tij/ saj ose me kërkesë të një dhe / ose më shumë ortakeve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të të gjithë kapitalit të shoqerise, dhe / ose audituesit të autorizuar nëse ka, dhe / ose nga likuiduesit kanë të drejtë të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme të Ortakeve. Një njoftim me shkrim i mbledhjes, duke përmendur qëllimin (et), vendin, datën dhe kohën e mbledhjes, do t'i dorëzohet me adrese zyrtare secilit ortak jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para datës së mbledhjes.
- 14.3 Njoftimi i takimit dërgohet me adrese zyrtare (njoftim zyrtar) dhe / ose e-mail.
- 14.4 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mbahen në ambientet e shoqerise ose në ndonjë vend tjetër jashtë tyre, pavarësisht nëse këto vende ndodhen në Shqipëri, ose diku tjetër jashtë vendit.
Për ortakët që banojnë në Shqipëri, kostot dhe shpenzimet për pjesëmarrjen në një mbledhje që do të zhvillohet jashtë vendit do të përballohen nga vetë ortakët.
- 14.5 Takimet e Asamblesë së Përgjithshme mund të bëhen gjithashtu përmes video-konferencave dhe / ose formave të tjera, mjeteve, kanaleve dhe / ose platformave të komunikimit elektronik, dixhital dhe / ose në internet, për sa kohë që identifikimi i secilit ortak është i mundur teknikisht dhe pasqyrohet siç duhet në procesverbalin e mbledhjes.
Në një rast të tillë, detajet specifike se si do të zhvillohet mbledhja do t'u njoftohen Ortakeve përmes një njoftimi zyrtar për mbledhjen.
- 14.6 Takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve do të zhvillohen në gjuhën Angleze. Çdo ortak ose përfaqësues i ortakut do të sigurojë shërbimet e përkthimit për veten e tij, nëse nuk kanë aftësitë e nevojshme në gjuhën angleze.

Perkthyes zyrtar: Alketa SKENDAJ

Neni 15

Pjesëmarrja ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme

- 15.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, duke pasur të drejtë për një numër votash të barabarta me përqindjen e kuotes që zotëron në kapitalin e shoqërisë.
- 15.2 Secili ortak ka të drejtë të përfaqësohet në procesin e vendimmarrjes nga një ortak tjetër, nga bashkëshorti ose nga ndonjë person tjetër fizik në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, me kusht që përfaqësuesit të autorizohen me prokurë për një qëllim të tillë.
- 15.3 Administratori i Shoqërisë mund të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, por nuk mund të përfaqësojë asnjë nga Ortaket në ndonjë prej mbledhjeve të tilla.

Neni 16

Kuorumi dhe vendim-marrja

- 16.1 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme në çdo rast është e vlefshme nëse Ortaket që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë, marrin pjesë në mbledhjen përkatëse.
- 16.2 Për vendimet që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve merr vendime të vlefshme me shumicën e votave të Ortakeve të pranishëm në mbledhje në përputhje me pikën 16.1 më lart.
- 16.3 Për vendimet që kërkojnë një shumicë të cilësuar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve merr vendime të vlefshme me 3/4 (*tre të katërtat*) e votave të Ortakeve të pranishëm në mbledhje me korumin e treguar në pikën 16.1 më lart. Vendime të tilla përfshijnë edhe pikat në vijim "b", "e", "f", "i", "k", "l", "m" dhe "n" të nenit 13 të Statutit.
- 16.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve nuk mund të thirret për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 16.1 më lart, Asambleja e Përgjithshme do të thirret përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtën rend dite.
- 16.5 Asambleja e Përgjithshme gjithashtu mund të marrë vendime të vlefshme përmes aktit të qarkullimit.

Neni 17

Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

- 17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve duhet të regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali i mbledhjes duhet të përmbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit të mbledhjes, emrin e sekretarit dhe rezultatet e

Perkthyes zyrtar: Alketa SKËNDAJ

votimit, si dhe çdo informacion tjetër të detyrueshëm të përcaktuar me Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare.

- 17.2 Kryetari i mbledhjes cakton një sekretar/e me qëllimin për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari i mbledhjes dhe sekretari.
- 17.3 Lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve i bashkëlidhen procesverbaleve të mbledhjeve.
- 17.4 Në rast të vendimeve të marra përmes aktit të qarkullimit, rezoluta duhet të nënshkruhet nga secili ortak në mënyrë që të jetë e vlefshme.

Neni 18

Menaxhimi i Shoqërise

- 18.1 Shoqëria do të menaxhohet nga 1 (një) ose më shumë administratorë, të emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.
- 18.2 Administratori i Shoqërise emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare (të rinovueshme). Administratori mund të shkarkohet përpara skadimit të mandatit me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.
- 18.3 Administratori do të jetë përgjegjës për menaxhimin e Shoqërise dhe do të përfaqësojë Shoqërine ndaj palëve të treta gjithmonë duke iu nënshtruar dhe në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe / ose dispozitat e legjislacionit në fuqi. Administratori do të ketë të gjitha kompetencat e menaxhimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërise, përveç atyre kompetencave që janë të rezervuara për organet e tjera të Shoqërise sipas këtyre akteve statutore dhe / ose legjislacionit në fuqi.
- 18.4 Administratori do të ketë kompetencat dhe detyrat e mëposhtme në lidhje me menaxhimin e veprimtarisë së Shoqërise:
 - a. të mbikëqyrë dhe zbatojë politikën e biznesit të Shoqërise dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve;
 - b. me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, të pershtase masa që bien në kompetencat e kësaj të fundit, të rekomandojë rezolutat që do të miratohen nga Asambleja e Ortakevedhe të ekzekutojë të tilla vendime;
 - c. të sigurojë që Shoqëria respekton legjislacionin në fuqi dhe standardet e kontabilitetit;
 - d. të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërise;
 - e. të përfaqësojë shoqërine ndaj palëve të treta;
 - f. të sigurojë që dokumentet dhe librat e kontabilitetit të Shoqërise të mbahen si duhet dhe të rregullta;
 - g. të thërrasë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve kur gjykohet e nevojshme për ruajtjen e interesave të Shoqërise;

Perkthyes zyrtar: Alketa SKENDAJ

- h. të përgatisë dhe nënshkruajë pasqyrat vjetore financiare të Shoqërisë, pasqyrat financiare të konsoliduara, të cilat i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve për miratim së bashku me propozimin për shpërndarjen e fitimeve;
- i. të kryejë të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqerine, siç mund të kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
- j. t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme të Ortakevenë lidhje me zbatimin e politikave tregtare;
- k. të aprovojë fillimin apo përfundimin e ndonjë procedure ligjore;
- l. të kryejë çdo veprim, detyrë, kompetencë dhe / ose akt tjetër siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi dhe / ose kjo Rregullore.

18.5 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e Shoqerise dhe të kryejë të gjitha veprimet e ligjshme, detyrat, kompetencat dhe / ose veprimet që nuk janë - me citim të ligjit, të kufizuara me anë të këtyre akteve statutore ose ndryshe - që duhet të ushtrohen / kryhen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve.

18.6 Administratori i Shoqerise është Z. **Artan Kraja**, shtetas shqiptar, i lindur më 16.07.1967, në Shkodër, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal: G70716045V.

Te dhenat e lidhura me Administratorin

Nenshkrimi i administratorit

Artan Kraja

Shtetas shqiptar

Lindur me 16.07.1967

Nr. Personal identifikimi: G70716045V

KAPITULLI IV

AUDITIMI STATUTOR, VITI FINANCIAR DHE PASQYRAT FINANCIARE, SHPERNDARJA E FITIMIT

Neni 19

Auditimi Statutor

Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, rishikimi i pasqyrave financiare dhe regjistrave kontabël të Shoqerise do të kryhet nga një auditues i ligjëruar, i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve.

Neni 20

Viti financiar dhe pasqyrat financiare

20.1 Viti financiar fillon në ditën e 1 Janarit dhe mbaron në ditën e 31 Dhjetorit të çdo viti. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqerise në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe skadon më 31 Dhjetor të vitit 2020.

Perkthyes zyrtar: **Arteta SKENDAJ**

- 20.2 Shoqëria duhet të mbajë në mënyrë të rregullt dhe të plotë dokumentat financiare (llogaritë financiare) të çështjeve të biznesit të shoqërisë në zyrën kryesore të saj dhe në vende të tjera të percaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Të tilla dokumenta *inter alia* (nder të tjera) duhet të përmbajë të gjitha të ardhurat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet e shoqërisë. Ortaket bieni ndërkohë të bashkëpunojnë me një shoqëri tjetër dhe shoqëria duhet të bashkëpunojnë me çdo ortak për të siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm financiar dhe analizat përkatëse në lidhje me shoqëritë tek ortakët e shoqërisë.
- 20.3 Pasqyrat financiare vjetore dhe nëse është rasti; inventari dhe raporti i auditit ligjor miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve.

Neni 21

Shpërndarja e fitimit

Ortakët kanë të drejtë të marrin fitimin e deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Llogaritja e fitimit bëhet në fund të çdo viti financiar. Fitimi shpërndahet midis ortakëve proporcionalisht me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit prej tyre në kapitalin e shoqërisë. Në mundësi të vendimit të kundërt sipas gërmes "r" të nenit 13, shoqëria do të shpërndajë fitimin çdo vit, në përputhje me nenin 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

KAPITULLI V

RIORGANIZIMI I SHOQËRISE, SHPËRBERJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISE

Neni 22

Shpërbërja/likuidimi dhe riorganizimi i shoqërisë

- 22.1 Shoqëria mund të shpërbëhet sipas rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve. Shpërbërja e Shoqërisë do të pasohet nga procedura e likuidimit.
- 22.2 Procedura e likuidimit bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 22.3 Në rast të shpërbërjes vullnetare të Shoqërisë, likuiduesi / ët emërohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve. Procedura e likuidimit dhe emërimi të likuiduesve kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 22.4 Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore sipas legjislacionit në fuqi. Riorganizimi nuk do të ketë pasoja tek të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë përpara tek palet e treta.

Perkthyes zyrtar: Alketa SKENDAJ

KAPITULLI VI

DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Neni 23

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe Ligji Qeverisë

23.1 Shoqëria është themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe ky Statut është hartuar dhe miratuar në përputhje me këto ligje.

Dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohen në lidhje me të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Statut. Në rast të mospërputhjeve midis dispozitave të këtyre neneve statutore dhe atyre të legjislacionit shqiptar në fuqi, dispozitat e këtij të fundit do të mbizotërojnë.

23.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtyre neneve statutore, po ashtu edhe çdo mosmarrëveshje që lind midis Korporatës dhe palëve të treta do të sillet për zgjidhje përpara Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 24

Të ndryshme

24.1 Këto rregulla Statutore formulojnë në themel marrëveshjen dhe mirëkuptimin midis Ortakeve në lidhje me krijimin dhe regjistrimin e Shoqërisë, po ashtu edhe sa i përket administrimit të saj.

24.2 Statuti aktual është hartuar në 4 (*katër*) kopje, me të njëjtën vlerë dhe përmbajtje ligjore, në gjuhët Shqipe dhe Angleze.

Në rast të mospërputhjeve midis versionit anglisht dhe shqip, versioni Anglisht do të prevalojë.

Nënshkruar, sot, në 09.10. 2020 nga të mëposhtmit:

ORTAKET

Për **FINSEC LTD**

GREG XHILLARI

Beat Britsch

President i Bordit të Drejtues

dhe përfaqësuesi i autorizuar

Perkthyes zyrtar: Alketa SKENDAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER VALBONA P. SINANI



DATE 16/10/2020
NR REP 1542

VËRTETIM PËRKTHIMI

Vërtetoj firmën e përkthyeses zyrtare **Alketa SKENDAJ** e bija e Hakiut, lindur më 20/08/1982, e pajisur me ID me nr. personal: I25820066E, banuese në Tiranë në Rrugën “ Tre Deshmoret”, përkthyesë e betuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila përktheu sipas origjinalit nga gjuha *Angleze* në gjuhën *Shqipe*, dokumentin bashkëlidhur dhe e firmosi atë në praninë time.

NOTERE
VALBONA P. SINANI

